

AKT THEMELIM
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“EURO SKELA” SH.P.K

Në Tiranë, sot më 26.03.2025 (dymijë e njëzet e pesë), u mor vendimi për themelimin e shoqërisë si më poshtë:

THEMELUESIT:

1. Z.Agustin Marashi, me atësi Prend, i datëlindjes 02.06.1978, lindur në Pukë dhe Banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Nr.H80602065K.
2. Shoqëria "ALBES INVEST" sh.p.k person Juridik Shqiptar, i regjistruar si i tillë pranë Regjistrat Kombëtar në QKB, pajisur me Nipt M17821501K, me adresë kryesore Shëngjin Rruga e “Plazhit” Godina Nr.35, Kati 1, përfaqësuar nga administratori Z. Besnik Paluca, me atësi Prend, i datëlindjes 28.02.1982, lindur në Lezhë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Nr. I2022 8193A.

Themelojmë sipas kërkesave të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008, dhe ligjin nr 9723 date 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ", si me poshtë:

Neni 1
Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë së vendosur nga Themeluesit është **"EURO SKELA" sh.p.k,**

Neni 2
Selia

Selia e Shoqërisë është e vendosur në Tiranë, në adresën: Njësia Nr.9, Rruga Don Bosko, pranë Kompleksit Vizion Plus, Tiranë, me adresë elektronike “euroskela@gmail.com”

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4
Objekti i Veprimtarisë



Dhënia me qira e skelave dhe shërbime të tjera për skelat (prodhim, tregtim, montim, çmontim). Punime të ndryshme ndërtimi për të gjitha llojet dhe kategoritë. Instalime impiantesh të ndryshme. Lyerje, patinim, dyer dhe dritare. Ndërtimi i objekteve **civile** dhe industriale. Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit. Aktivitet në fushën e imobiliareve: blerje, shitje dhe qira e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme. Punime ndërtimi dhe restaurimi për objekte të ndryshme. Hapja dhe operimi i hoteleve dhe kampingjeve. Aktivitetet e argëtimit për fëmijë dhe të rritur. Bare, restorante, lavazhe, parkime, dhe aktivitete të tjera rekreative. Shërbime transporti (taksi, transport udhëtarësh dhe mallrash brenda dhe jashtë vendit). Shitje dhe qira e automjeteve dhe makinerive të ndryshme. Aktivitetet e agjencive të udhëtimit dhe turizmit. Tregti me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore, industriale dhe kozmetike. Tregti elektroshtëpiake dhe paisjeve elektronike. Prodhimi, ambalazhim, tregtimi dhe shpërndarja e ujit natyral, pijeve freskuese dhe produkteve ushqimore. Përpunimi dhe tregtimi i lëndës drusore, mobiljeve, pllaka, parkete dhe materialeve të lejuara në fushën e ndërtimit. Grumbullim dhe tregtim i materialeve të ndryshme si hekur, alumin, bronz, bakër dhe lëndë të tjera të riciklueshme (skrap). Shitje e materialeve plastike. Punime në hidrocentrale dhe përpunim të materialeve industriale (zhavorre, gelqeror, ranor, etj.) Aktivitet në fushën e sigurisë private. Shërbime dhe asistencë për hidrocentrale dhe punime të ndryshme në karrierë. Import-eksport i produkteve ushqimore, pijeve dhe materialeve të tjera të lejuara nga legjislacioni. Importi dhe eksporti i kafes, pijeve dhe produkteve ushqimore. Rritja dhe mbarështimi i kafshëve dhe ngritja e fermave. Agroturizëm dhe aktivitete të lidhura me bujqësinë dhe natyrën. Arkitekturë dhe aktivitete inxhinierike (projektim, konsulencë dhe zbatim). Trajnime dhe kurse në fusha të ndryshme si hospitality, turizëm, etj.

Neni 5

Kapitali Themeltar

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100,000 (njëqindmijë) Lekë. Kapitali Themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, të gjitha të nënshkuara, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin Themeltar të Shoqërisë përcaktuar në neni 10 (dhjetë) të Statutit.

Neni 6

Kontributet

Ortakët e Shoqërisë zotërojnë kuotën e përcaktuar në vlerë nominale dhe përqindje si mëposhtë:

1. **Z.Agustin Marashi** i cili zotëron 1 kuotë, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek, të llojit në kontribut "Para", me pjesëmarrje në përqindje në masën 50 %; e **barabartë me 1 (një) kuotë.**
2. **Shoqeria "ALBES INVEST" sh.p.k,** i cili zotëron 1 kuotë, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek, të llojit në kontribut "Para", me pjesëmarrje në përqindje në

masën 50 %; e barabartë me 1 (një) kuotë.

Neni 7 Transferimi i Kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 Administrimi

Me këtë Akt Themelimi emërohet **1 (një)** Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë vijon:

- **Z.Agustin Marashi**, me atësi Prend, i datëlindjes 02.06.1978, lindur ne Pukë dhe Banues ne Tiranë, shtetas shqipetar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Nr.H80602065K.

Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" i ndryshuar, dhe nenit 14 të Statutit.

Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim Administratori mund t'i drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund t'i delegojë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit sa më lartë cituar.

Neni 9 Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe duke patur secili ekzemplarin origjinal dhe nënshkruhet nga themeluesit.

THEMELUESIT:

Z. Agustin Marashi

Agustin Marashi


Shoqëria "**ALBES INVEST**" sh.p.k

Përfaqësuar nga Administratori

Z. Besnik Paluca

Besnik Paluca


ALBES INVEST SHPK
NIP: M17821501X
442HE